



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1168 prot.

Elbasan, më 03.05.2023

VENDIM

Nr. 17 date 03.05.2023

**"PËR
HAPJEN E PROGRAMIT TE STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR
"CERTIFIKATË PËR FORMIMIN PSIKOPEDAGOGJIK" NË DEPARTAMENTIN E
"METODOLOGJIVE TË MËSIMDHËNIES", FAKULTETI I SHKENCAVE TË
EDUKIMIT"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 3, pika 2, germa b); nenin 38, pika 1, germa dh); nenin 81, pika 1,2,3 në Udhëzimin të MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV/A, pika 3, germa b , në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar pika 2.9, germa c), si dhe në vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "A. Xhuvani" Nr. 10, datë 02.05.2023 "Për hapjen e programit te studimit të formimit të vazhduar "Certifikatë Për formimin Psikopedagogjik" në Departamentin e "Metodologjive të Mësimdhënies", në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të UE, për vitin akademik 2023-2024, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar "**Certifikatë për Formimin Psikopedagogjik**", në departamentin e Metodologjive të Mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, për vitin akademik 2023-2024.
2. Burimi i financimit për këtë program studimi do të jetë tarifa e shkollimit për program dhe pa efekte shtesë nga buxheti i UE-së.
3. Tarifa e shkollimit do të jetë 1000 lekë për kredit.
4. Ky vendim i dërgohet MAS për procedurat e mëtejshme të miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Ardian DURMISHI